



DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL
DIREKCIJA ZA POLIOPRIVREDU I RURALNI RAZVOJ
DIRECTORATE FOR AGRICULTURE AND RURAL DEVELOPMENT

Data/Datum/Date:	29.08.2024
Nr./Br./No	12/19
Nga/Od/From:	Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural: Gojart Bajrami
Lënda/Predmet/Subject:	Thirrje për aplikim

Drejtorija për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale neni 61 paragrafi 62.3, Rregullores Nr.01-060/01-24495/17 për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve neni 5 paragrafin 5.1 dhe 5.2, neni 19 paragrafi 19.1, 19.1.3 dhe 19.2.4, bënë këtë:

Thirrje për aplikim

Drejtorija për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në bashkëpunim me Fondacionin "Amaneti", është duke zbatuar projektin "Dhurimi i granteve bujqësore për ekonomitë familjare në territorin e Komunës së Shtimes". Projekti do të zbatohet në komunën e Shtimes gjatë vitit 2024 dhe përfshinë:

- 13 kultivatorë (*kultivator me tri funksione: pllug, frezë dhe kositëse*)
- 13 sera (*serë me 1.5 ari me konstruksion metalik*)
- 14 përfitues bletësh (*5 koshere me nga 10 rama*)
- 13 përfitues delesh (*kope me 5 dele*)
- 15 përfitues me kotece me pula (*një kotec me 30 pula*)

Ftohen të gjithë fermerët, të aplikojnë në këtë thirrje për këto kategori të cilat është hapur thirrja. Kriteret që duhet të plotësoj aplikuesi janë:

- Të jetë banorë rezident i Komunës së Shtimes
- Të jetë prodhues i perimeve në serë 5 ari e më tepër dhe në fushë hapur 20 ari e më tepër (*vetëm për aplikuesit për Kultivator*)
- Parcela ku do të ndërtohet sera duhet të jetë brenda territorit të komunës dhe të jetë tokë e përshtatshme për kultivimin e perimeve (*vetëm për aplikuesit për serë*)
- Të jetë bletar i cili ka më pak se 30 shoqëri bletësh (*vetëm për aplikuesit për shoqëri bletësh*)
- Të jetë blegtor, kultivues i deleve më pak se 30 krerë (*vetëm për aplikuesit për dele*)

Përparësi do të kenë:

- Aplikuesit të cilët nuk kanë përfituar grande nga komuna gjatë tri viteve të fundit
- Aplikuesit me gjendje të rëndë ekonomike
- Numri i anëtarëve të familjes,
- Familjet me anëtarë në gjendje të rëndë shëndetësore (hendikep apo sëmundje kronike),
- Nënave vetëushqyese

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Kopja e dokumentit identifikues të Republikës së Kosovës
- Dëshmia e pagesës së tatimit në pronë
- Çertifikata e bashkësisë familjare
- NIF (Numri Identifikues i Fermerit), për ata të cilët aplikojnë për kultivator
- Aplikacioni i plotësuar

Afati për aplikim: 30 Gusht 2024 – 09 Shtator 2024

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën pritëse